



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KRYETARI I KOMUNËS**

Bazuar në nenet 13, 17 shkronja m) dhe 58 shkronja g) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, nr. 03/L-040, nenet 16, 19 paragrafi 1.13 dhe 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës, nr. 01-020/01-0050862/18, nxjerr:

### **U R D H Ë R E S Ë**

#### **I**

**OBLIGOHET** i tërë personeli i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare duke përfshirë edhe Qendrat e Mjekësisë Familjare dhe Ambulantat e Mjekësisë Familjare në territorin e Komunës së Podujevës, varësisht punëve dhe detyrave të përcaktuara nga vendi i punës që mbajnë, që konform rregullativës përkatëse ligjore;

- **Të respektojnë detyrat dhe përgjegjësitë e punës;**
- **Të respektojnë orarin e punës;**
- **Të respektojnë kodin e mirësjelljes dhe kodin e veshjes;**
- **Të ngitet niveli i higjienës në të gjitha objektet shëndetësore**

#### **II**

Obligohen U.D. Drejtori i QKMF-Podujevë dhe përgjegjësit e njësive tjera (QMF, AMF) që të ndërmarrin të gjitha masat dhe veprimet e nevojshme për respektimin e kësaj Urdhërese, në të kundërtën do të ndërmerren masa disiplinore dhe masa tjera përkatëse ligjore.

#### **III**

Për mbikëqyrjen e zbatimit të kësaj Urdhërese, pa përjashtuar edhe rregulla dhe përgjegjësi tjera të parapara me rregullativë ligjore, obligohet Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

#### **IV**

Urdhëresa hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet:*  
*Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale*  
*U.D. drejtorit të QKMF-së*  
*Zyrës për Marrëdhënie me Publikun dhe Komunikim*  
*Arkivit*

**Nr. 02-500/01-0078164/20**  
**Podujevë, 24 dhjetor 2020**



**Kryetari i Komunës**  
**Shpejtim Bulliqi**